



**Hapet thirrja për mobilitete (bursa) stafi të UPT-së,  
në kuadër të Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus+  
në Ondokuz Mayıs University (OMÜ), Turqi**

Në kuadër të Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa, për stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, në Ondokuz Mayıs University.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:** Shkëmbimin e stafit për mësimdhënie ose trajnim (teaching or training).

**Fusha e studimit/trajnitimit:** Të gjitha degët

**Kohëzgjatja e bursave:** 5 ditë + 2 ditë udhëtim

**Numri total i stafit për trajnim/mësimdhënie:** 4

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për mësimdhënie, ose trajnim për stafin:**

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Diploma e nivelit të fundit të studimeve;
- Çertifikata e gjuhës së huaj (Niveli minimal i gjuhës angleze B2);
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës\*;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës\*\*;
- Dokumenti i Mobility Agreement (Staff Mobility for Teaching or Staff Mobility for Training) për stafin akademik në universitetin pritës\*\*\*.

*\*Plani i mobilitetit për mësimdhënie (teaching), ose trajnim (training), si dhe periudha e propozuar e mobilitetit për stafin akademik, duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë ku aplikanti bën pjesë.*

*\*\*Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobiliteteve si staf akademik në universitetin pritës, paraprakisht duhet të kenë aprovimin nga universitetin pritës (Dekan/Titullar Departamenti ose program studimi/Profesor), për kryerjen e aktivitetit mësimdhënës ose research gjatë periudhës së mobilitetit. Ai/ajo do të duhet t'ju dërgojë një dokument paraprak aprovues, të cilin do të duhet ta bashkangjisni me dokumentet e tjera për aplikimin tuaj.*

*\*\*\* Mobility Agreement për Teaching (mësimdhënie) ose Training (trajnim) për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

**Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT:**

**Deri më 18 Mars 2022**

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al) ose [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al).